



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 730/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e shoqërisë “Toni Security” sh.p.k, “Oktapus”sh.p.k., “ISA” sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k. si dhe anulimin e shortit të datës 17.08.2018, mbajtur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-76254-06-25-2018, me objekt : me objekt “Blerje e Sherbimit te Ruajtjes me Roje Private” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 13’683’216 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues:

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Durrës
Adresa: Lagja nr.8, Rr.A.Goga, Durrës

Subjekte të Interesuara:

“Vrana Security Group” sh.p.k
Adresa: Përballë Fleg Ship Center Durrës

“Oktapus” shpk

Adresa: Rruga “Bardhok Biba”, Old Tirana Building,
Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-76254-06-25-2018, me objekt : me objekt “Blerje e Sherbimit të Ruajtjes me Roje Private” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 13’683’216 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.2. Në datë 07.08.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, operatorit ekonomik ankimues dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se autoriteti kontraktor në datën 16.08.2018 i ka dërguar mesazh elektronik operatorëve ekonomikë me vlerë të njëjtë ekonomike konkretisht citoj: “[...]Ju jeni pjesëmarrës ne procedurën e prokurimit "Blerje e Sherbimit të Ruajtjes me Roje Private – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj", me Autoritet Kontraktor Spitali Rajonal Durres.Komisioni i Vleresimit të Ofertave, pasi shqyrtoi ne menyre nominative të gjitha ofertat e regjistruara ne sistemin eletronik të prokurimeve, nga vleresimi perfundimtar rezultoi se janë paraqitur oferta ekonomike me vlera të barabarta. Ne keto rrethana, bazuar edhe ne Ligjin Nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, si edhe ne rregullat e prokurimit publik të miratuara me VKM Nr. 914 date 29.12.2014 i ndryshuar, jeni të lutur të paraqiteni ditën e Premte, me date 17.08.2018, ora 14.00 ne ambientet e Drejtorise se Spitalit Rajonal Durres per hedhjen e shortit..[...]”

II.4. Referuar procesverbalit nr. 1674/6 prot datë 17.08.2018 i mbajtur pranë autoritetit kontraktor Spitalit Rajonal Durrës rezulton se, procesverbali është mbajtur në prani të KVO-së dhe Njesisë së prokurimit në autoritetin kontraktor datë 17.08.2018 ora 14:00, si dhe 5 pesë) përfaqësuesve të operatorëve ekonomik pjesëmarrës konkretisht: “Vrana Security Group” shpk, “Oktapus” sh.p.k., BOE “ISA” sh.p.k. & “Trezhnjeva” sh.p.k., BOE “Toni Security” sh.p.k. & “Eurogjici Security” sh.p.k. dhe “Nazeri 2000” shpk.

II.5. Në datën 17.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

1. “Toni Security” sh.p.k	13,390,327.96 lekë, kualifikuar
2. “Oktapus” sh.p.k	13,390,327.96 lekë, kualifikuar
3. “Internacional Security Albania” sh.p.k.	13,390,327.96 lekë, kualifikuar
4. “Vrana Security Group” sh.p.k.	13,390,327.96 lekë, kualifikuar
5. “Nazeri 2000” sh.p.k.	13,390,327.96 lekë, kualifikuar

II.6. Në datën 23.08.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k, “Oktapus”sh.p.k., “ISA” sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k. si dhe anulimin e shortit të datës 17.08.2018, mbajtur nga autoriteti kontraktor me argumentat si më poshtë vijon:

[...] Nepermjet kesaj ankese duam të bejme prezent nje problem qe konsiston ne shkeljet e kryera nga Autoriteti Kontraktor Spitali Rajonal Durres per procedurën e prokurimit organizuar ne date 07.08.2018 me objekt "Blerje e Sherbimit të Ruajtjes me Roje Private" - Marreveshje Kuader -me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara me afat 12 muaj"si me poshte: Ne daten 16.08.2018

jemi njoftuar ne SPE per hedhjen e shortit (pa u ber klasifikimi i ofertave) prane Spitalit Rajonal Durres per ne date 17.08.2018, ora 14.00.

Dhe në datën 17.08.2018 në orën 15:51 në mënyrë elektronike është dërguar njoftim mbi klasifikimin e shoqërive pjesmarrëse në këtë procedurë prokrimi: [...]

Se pari, kundërshtojmë klasifikimin e datës 17.08.2018, pasi duhet të skualifikohen shoqëritë "TONI-SECURITY", "OKTAPUS", "INTERNACIONAL SECURITY ALBANIA" dhe "VRANA SECURITY GROUP", për të cilat po ju paraqesim argumentimin tonë si më poshtë: Keta Operator Ekonomik nuk plotësojnë kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas Shtojcës 1, Sqarime pika 2, të DST, pasi nuk kanë paraqitur preventivin për 1 vendroje me 4.98 roje/muaj, duke mos përbushur të gjithë elementet e nevojshëm për krahasimin e ofertës sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit. Qëndrim i mbajtur nga KPP me vendime të ngjashme (vendimi nr. 500/2018, date 25.07.2018).

Se dyti, Ak duhet të skualifikojë shoqëritë TONI-SECURITY, OKTAPUS, INTERNACIONAL SECURITY ALBANIA dhe VRANA SECURITY GROUP, pasi nuk përbushin kërkesën 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike pika 3, nuk kanë paraqitur 15 certifikata të vlefshme brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmerisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike.

Se treti, Ak duhet të skualifikojë shoqëritë Toni-Security, Oktapus, Internazional Security Albania dhe Vrana Security Group pasi, nuk kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt lidhur me Akt-Miratimin e qendres së kontrollit në përputhje me Licencën e shoqërisë të parashikuar në ligj. Konkretisht krahasuar nr i licences në Akt-Miratimin e qendres së kontrollit leshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore të Qarkut Durres me Licencën e shoqërisë të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezultojnë mospërputhje të theksuara ndërmjet numrave të licences dhe datave në Akt-Miratimit (si dokument me vete) me numrat dhe datat e Licences (nuk përputhet numri dhe data e Licences). Në këto kushte gjykojmë se operatorët ekonomik Toni-Security, Oktapus, Internazional Security Albania dhe Vrana Security Group nuk kanë dorëzuar dokumentacion rreth përputhje me kriteret e kualifikimit. Duke qenë se në Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike shumë operatore kanë emra të ngjashëm kompanish është e domosdoshme që verifikimi i aktit të miratimit të përputhet me numrin e licences së kompanisë përkatëse. Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i plotë e rrjedhimisht nuk është i vlefshëm për këtë procedurë prokurimi. Qëndrim i mbajtur nga KPP me vendime të ngjashme (vendimi nr. 516/2018 date 03.08.2018).

Se katërti, Kundërshtojmë hedhjen e shortit të datës 17.08.2018, ora 14.00 pasi përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmerisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i Kpr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Teresia e elementeve të mesipër lidhet ngushtesisht me elemente të ligjshmerisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. " Në nenin 63 pika 3 e lex specialis, LPP parashikohet se "Me

marrjen e ankeses me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedures se prokurimit, derisa ankesa të jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi perpara skadimit to afatit kohor, to percaktuara ne pikat 5 dhe 6 to ketij neni "

Gjithashtu ne nenin 63 pika 6 e lex specialis i cili parashikon të drejten ankimit prane Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesen brenda afatit kohor të percaktuar ne piken 5 to ketij neni, ose e refuzon ate, ankimesi mund të paraqese nje ankese me shkrim ne Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 diteve nga dita e neserme e punes, pas perfundimit të afatit kohor, të percaktuar ne piken 5 to ketij neni, ose, ne rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, qe nga dita kur ankuesi eshte njoftuar nga autoriteti kontraktor. Nje kopje me shkrim e ankeses i dergohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...] ". Qendrim i mbajtur nga KPP me vendime to ngjashme (vendimi nr. 192/2018 date 05.04.2018).Referuar sa me siper konstatojme se, hedhja e shortit nga autoriteti kontraktor ne daten 17.08.2018 eshte ne kundershtrim të hapur me ligjin, pasi eshte kryer brenda hapesires kohore ne to cilen operatoreve ekonomike ankimes, ligjerisht, u lind e drejta e ushtrimit të ankimit administrativ prane Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. AK ka detyrimin të prese perfundimin e plote të afateve të ankimit të operatoreve ekonomike ankimes ne zbatim to nenit 63 pika 2 pika 3 dhe piak 6 e LPP-se.

Kerkojme qe nga ana e AK të behet anullimi i shortit të dates 17.08.2018 pasi nuk jane plotesuar afatet e ankimit sipas LPP.

Nga argumentimet e bera sa me siper kerkojme nga AK anullimin e shortit dhe skualifikimin e shoqerive TONI-SECURITY, OKTAPUS, INTERNACIONAL SECURITY ALBANIA dhe VRANA SECURITY GROUP pasi nuk permbushin kerkesat e kerkuara nga AK ne dst. Shpresojme qe ankesa jone të merret ne konsiderate, pasi do të jemi të detyruar ne ndjekjen e të gjitha shkalleve të tjera të ankimit.

II.7. Në datën 28.08.2018, me shkresën nr. 2104/6 prot, datë 28.08.2018, shoqëria "Nazeri 2000" shpk është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor me pretendimet si më poshtë:

"[...] Se pari: Kundershtoni ofertat e operatoreve të vleresuar nga KVO, me pretendimin se nuk kane paragitur preventivin per I vendroje me 4,98 roje ne muaj.

Pas verifikimeve të bera nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, per sa kohe ju nuk mund të faktoni, dokumentoni pretendimin tuaj, Autoriteti Kontraktor mund t'ju siguroje se secili nga operoret e kerkuar nga ju të skualifikohet, ka dorezuar ofertat ekonomike sipas modelit të kerkuar nga AK ne DST. Dhe ofertat jane krahasuar me shume korrektesi per të gjithë OE.

Per sa siper ankesa juaj nuk qendron.

Se dyti. Kundershtoni kualifikimin e operatorit ekonomik "Toni Security" Shpk, "Internacional Security Albania" Shpk, "Oktapus" shpk dhe "Vrana Security" Shpk, me pretendimin se nuk plotesojne numrin e punonjeve me certifikata sherbimi sipas Ligjit Nr. 75/2014 "Per Sherbimin e Sigurise Fizike.

Pas verifikimeve të bera nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, per sa kohe ju nuk mund të faktoni, dokumentoni pretendimin tuaj, Autoriteti Kontraktor mund t'ju siguroje se secili nga operoret e kerkuar nga ju të skualifikohet permbush kriterin per të pasur, sipas percaktimeve të DST të pakten 15 punonjes sherbimi të certifikuar brenda afatit 4 vjecar.

Per sa siper ankesa juaj nuk qendron.

Se treti: Kundershtoni kualifikimin e operatorit ekonomik "Toni Security" Shpk, "Internacional Security Albania" Shpk, "Oktapus" shpk, "Vrana Security" Shpk, me pretendimin se nuk plotesojne kriterin per Akt-Miratimin e salles se kontrollit sipas modelit qe i bashkelidhet Udhezimit Nr. 130 date 15.03.2018 të Ministrisë të Brendshme. Autoriteti Kontraktor, ju informon se bazuar ne Kodin e Procedures Civile të Republikës së Shqipërisë, konkretisht nenet 8, 11 dhe vecanerisht neni 12 sipas të cilit "Pala qe pretendon nje të drejte, ka detyrimin qe, ne perputhje me ligjin, të provoje faktet mbi të cilin bazon pretendimin e saj", ankesa juaj eshte e aprovuar dhe si e tille nuk mund të pranohet.

Por, AK duke vleresuar faktin se ankesa eshte bere brenda afatit të ankimit dhe nga nje subjekt i interesuar drejteperdrejte ne kete proces, i cili ka dorezuar Akt-Miratimin me Nr.166 prot date 24.10.2018 e nxjerr nga Drejtoria Vendore e Policise Durrës sipas Ligjit Nr. 75/2014 "Per Sherbimin Privat to Sigurise Fizike" dhe Udhezimit nr. 157 date 01.04.2015 të Ministrisë të Puneve të Brendshme, ju informon se ne lidhje me kete pike të ankeses tuaj i eshte referuar arsyetimit dhe gjykimit të dhene nga KPP me Vendimin Nr. 497/2018 date 24.07.2018 sipas të cilit eshte gjykuar se deri ne miratimin e aktit të ri nga Drejtorite Vendore të Policise ne zbatim të kerkesave të Udhezimit të Ministrisë të Brendshme nr.130 date 05.03.2018 dhe faktit se ne monitorimin e ushtrimit të veprimtarise se subjekteve të ruajtjes dhe sigurise fizike, rol të vecante kane Drejtorite vendore të Policise se Shtetit, DVP Durrës ne rastin konkret per secilin nga operatorët e kerkuar nga ju qe të skualifikohen, ashtu si edhe per vete subjektin tuaj, ka konstuar me ane të shkreses Vertetim "Per pjesnarrje ne tender" se e keni/kane të miratuar Qendren e Kontrollit të secilit operator pjesmarres, vleresimi i KVO-se se Spitalit Rajonal Durrës per kete procedure prokurimi ne lidhje me dokumentin "Akt-Miratimi per qendren e kontrollit" të dorezuara nga operatorët ekonomik eshte i drejte dhe ankesa juaj nuk qendron.

Se katerti: Ju kundershtoni hedhjen e shortit perpara afateve të ankimit sipas nenit 63 to LPP Nr. 9643 date 20.11.2006, i ndryshuar, duke pretenduar se nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk ishte bere akoma vleresimi ose kuotimi ne system i vlerave ekonomike të ofruara nga operatorët ekonomik pjesmarrës ne kete procedure.

Public Health Sector

Referuar vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ju informojme se nga ana e KVO jane kryer me korrektese dhe ne zbatim të plote të detyrave të paracaktuara ne nenin 53-55 Te LPP dhe neneve 58,64, dhe 68 to VKM Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave to prokurimit publik" i ndryshuar, si edhe ka ndjekur me shume perpikmeri të gjitha hapat e Udhezimit nr. 06 date 16.01.2018 "Per perdorimin e marrveshjes kuader dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike", konkretisht pika 3.2 e manualit bashkelidhur ketij udhezimi. Procedura e mesiperme "Ruajtja e godines me roje private" - Marrveshje kuader me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet jane të percaktuara - me afat 12 muaj, eshte realizuar me mjete elektronike, gje e cila e ben lehtesisht të verifikueshme cdo veprim të kryer nga secili prej anetareve të KVO ne sistemin SPE.

Dispozita ne të cilin ju bazoni pretendimin tuaj se "AK nuk ka zbatuar afatet e ankimit ne lidhje me daten e hedhjes se shortit" nuk qendron per arsye sepse AK, nepermjet Komisionit të Vleresimit të Ofertave, kryen të gjithë veprimet sipas rendit të percaktuar ne nenin 66 dhe 67 to VKM Nr.914 date 29.12.2014, veprime të cilat perfshijne edhe hedhjen e shortit si nje menyre transparente per percaktimin e fituesit. Dhe jane veprime ne vazhdimesi të njera-tjetres ne funksion të perfundimit të detyrave të KVO-se. E cila per kete procedure i ka dokumentuar veprimet me dokumentat ne zbatim të nenit 12 të LPP. Dhe vetem pas perfundimit të të gjitha ketyre veprimeve, kualifikimit-shqyrtimit- vleresimit-klasifikimit të ofertave, dhe perpara pegatitjes se "Raportit Perfundimtar" nga ana e KVO, operatorët ekonomik

pjesmarres kane të drejten e ankimit. Te drejte të cilen AK po e zbaton me korrektese ne perputhje të plote me percaktimet e nenit 68 to VKM Nr. 914 date 29.12.2014[...].”

II.8. Në datën 31.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me te njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.2068/2 datë 07.09.2018 protokolluar me tonën me nr. 1455/2 datë 10.09.2018 me objekt *“Informacion në zbatim të vendimit nr. 1455/1 datë 04.09.2018”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit së bashku me mostrat e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,



III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k, “Oktapus”sh.p.k., “ISA” sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k.me argumentin se *“Se pari, kundërshtojm klasifikimin e dates 17.08.2018, pasi duhet të skualifikohen shoqerite TONI-SECURITY, OKTAPUS, INTERNACIONAL SECURITY ALBANIA dhe VRANA SECURITY GROUP, per të cilat po ju paraqesim argumentimin tone si me poshte: Keta Operator Ekonomik nuk plotesojne kerkesen e percaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas Shtojces 1, Sqarime pika 2, të DST, pasi nuk kane paraqitur preventivin per 1 vëndroje me 4.98 roje/muaj, duke mos permbushur të gjithë elementet e nevojshem per krahasimin e ofertes sikurse eshte percaktuar ne dokumentat e tenderit. Qendrim i mbajtur nga KPP me vendime të ngjashme (vendimi nr. 500/2018, date 25.07.2018).”* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se në Njoftimin e Kontratës, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vëndroje ve)	Numri total i rojeve për vëndroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Shërbimi i ruajtjes se godines vëndroje me 3 turne (I+II+III)	(X)	3	(X)	(X)	(X)

2.	Shërbimi i ruajtjes se godines se për 1 vëndroje me 2 turne (I+II)	(X)	1	(X)	(X)
3	Shërbimi i ruajtjes se godinës se për 1 vëndroje (II)	(X)	1	(X)	(X)
4	Shërbimi i ruajtjes se godines se për 1 vëndroje me 1 turne (I)	(X)	1	(X)	(X)
	Shërbimi i ruajtjes se godinës se për 1 vëndroje me 1 turne (III)	(X)	1	(X)	(X)
3.	Ruajtja e objekteve me sistem alarmi	(X)	4	(X)	(X)
	<i>Oferta Neto në total</i>				
	<i>TVSH (%)</i> (X)				
	<i>Oferta total</i> (X)				

I. Njoftimi i Kontrates, pika 2.10 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i Kontratës/marrëveshjes kuadër

si edhe Shtojca 11 SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Ne tabelen e vendosur ne DST nga ana jonë janë vend rojet dhe jo numri i rojeve, për ta bërë më të qartë po e ribëjmë perseri duke përcaktuar edhe numrin e rojeve për cdo vënd roje. Sqarojmë se në shtojcën 11 te “Grafiku i shërbimit” janë vende vënd rojet se ku do te mbuloohen me sherbim privat, per tua bere me te lehte ne llogaritjen e fondit limit jemi munduar qe ti grupojme vënd rojet (poliklinik 1 vënd roje turni i pare,hyrja ne pavionin e kirurgjise 1 vënd roje turni i dyte si dhe 1 vënd roje tanker+territorin e jashtem turni i trete), po te shihet me kujdes te tre keto vënd roje plotesojne nje vënd roje me tre turne ,pra ky grupim nuk ndikon ne fondin limit pasi nuk eshte se jane grupuar tre vënd roje me te njejtin turn .

Sqarime

(Shembulli i meposhtem eshte ne rastin e nje vëndroje me tre turne dhe sherbim 24 ore):

1. Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vënd roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vënd-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Emërtimi
1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

Analiza e kostos

- Operatoret janë të detyruar të paraqesin

preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".

- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).
- Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.

III.1.2. Në Shtojcën.9, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" "Kapaciteti teknik", pika 6 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

"6. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur. Per nje vend roje ne nje dite. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)".

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës së ekonomikë të dorëzuar nga shoqëritë "Oktapus" sh.p.k., "Vrana Security Group" sh.p.k. rezulton se është paraqitur formulari i ofertës sipas Shtojcës 1, si dhe analiza e kostos në të cilën pasqyrohet vetëm analiza e kostos për një roje në muaj, ndërkohë që mungon analiza e kostos për një vendroje në muaj.

Ndërsa në lidhje me operatorët ekonomikë "Toni Security" sh.p.k. "ISA" sh.p.k. nga shqyrtimi i ofertës së dorëzuar nga këta të fundit rezulton se, kanë paraqitur formularin e ofertës sipas Shtojcës 1, si dhe analizën e kostos në të cilën pasqyrohet analiza e kostos për një roje në muaj, si dhe analiza e kostos për një vendroje në muaj.

III.1.4. Referuar nenit 53, pika 3 dhe 4 të LPP-së, ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë

ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se formulari i ofertës i paraqitur nga shoqëritë “Oktapus”sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k janë sipas Shtojcës.1, por i mungon një nga elementët dhe konkretisht analiza e kostos për një vëndroje në muaj, sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke mos përmbajtur të gjithë elementët e nevojshëm për krahasimin e ofertës.

Ndërsa në lidhje me shoqëritë “Toni Security” sh.p.k. dhe “ISA” sh.p.k., referuar sa më lart kanë plotësuar shtojcën 1 formularin e ofertës konform kriterëve të parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të procedurës objekt ankimi.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për operatorin ekonomik Oktapus”sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k qëndron, ndërsa për operatorët ekonomikë “Toni Security” sh.p.k. dhe “ISA” sh.p.k., nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Oktapus”sh.p.k., dhe “Vrana Security Group” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e operatorëve ekonomikë “Oktapus”sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Public Health Sector

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k, dhe “ISA” sh.p.k me argumentin se “*pasi nuk permbushin kerkesen 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike pika 3, nuk kane paraqitur 15 certifikata të vlefshme brenda afatit 4-vjecar të vlefshmerise të parashikuar ne nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat të sigurise fizike."* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, si dhe “Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se:

3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 15 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Durrës;

Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se BOE “Toni Security” shpk& “Eurogjici Security” shpk si dhe BOE “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm, kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

BOE “Toni Security” shpk& “Eurogjici Security” shpk

Vërtetim Nr. 18 prot, datë 01.06.2018, për operatorin ekonomik “Toni Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku numri i punonjësve të shërbimit gjithsej është 26 punonjës.

Vërtetim Nr. 15 prot, datë 06.04.2018, për operatorin ekonomik “Eurogjici Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku numri i punonjësve të shërbimit gjithsej është 20 punonjës.

Çertifikata punonjësish shërbimi “Toni Security” sh.p.k. “Eurogjici Security” shpk

BOE “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k.

Vërtetim Nr. 19 prot, datë 01.06.2018, për operatorin ekonomik “I.S.A” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku numri i punonjësve të shërbimit gjithsej është 38 punonjës.

Vërtetim Nr. 02 prot, datë 05.01.2018, për operatorin ekonomik “Trezhnjeva” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku numri i punonjësve të shërbimit gjithsej është 11 punonjës.

Çertifikata punonjësish shërbimi “I.S.A.” sh.p.k. “Trezhnjeva” shpk

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.3.5. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.
3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.
4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.
5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.

III.3.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.3.7. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: “Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon:

Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.”

III.3.8. Në korrespondencën e Komisionit të Prokurimit Publik me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në lidhje me vlefshmërinë e certifikatave, kjo e fundit citon se: “Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e

performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit aktual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e certifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penaliteti i punonjësve të cilët sipas ligjit aktual paisen me certifikatat me afat 4 –vjeçar.

Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.

III.3.9. Në rastin konkret, nisur nga kriteri i përcaktuar në dokumentat e tenderit ku nga ana e autoritetit kontraktor, është kërkuar vetëm paraqitja e certifikatave të punonjësve dhe konkretisht për 15 punonjës shërbimi, KPP konstaton se, certifikatat e paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Toni Security” sh.p.k. & ”Eurogjici Security” sh.p.k. si dhe certifikatat e paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ”I.S.A.” sh.p.k.& ” Trezhnjeva” sh.p.k. janë të vlefshme dhe brenda afatit 4 vjeçar në përputhje me numrin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi të vlefshme rezultojnë një numër i konsiderueshëm mbi 15 certifikata.

Nga ana tjetër, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, siç cituam edhe më sipër, sqaron më së miri në lidhje me afatin e vlefshmërisë së këtyre certifikatave në korrespondencën zyrtare me Komisionin e Prokurimit Publik.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ”Toni Security” sh.p.k. & ”Eurogjici Security” sh.p.k., si dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë ”I.S.A.” sh.p.k.& ” Trezhnjeva” sh.p.k. e përmbushin kriterin e përcaktuar në shtojcën 8, kapaciteti ligjor dhe teknik të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi kanë paraqitur mbi 15 certifikata të vlefshme për punonjësit e shërbimit duke plotësuar numrin e kërkuar në dokumentat e tenderit prej 15 certifikatave për numrin e punonjësve të kërkuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për bashkimin e operatorëve ekonomikë ”Toni Security” sh.p.k. & ”Eurogjici Security” sh.p.k dhe bashkimin e operatorëve ekonomikë ”I.S.A.” sh.p.k.& ” Trezhnjeva” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k, dhe “ISA” sh.p.k me argumentin se “*Se treti, Ak duhet ti skualifikoje shoqerite Toni-Security, Internacional Security Albania pasi, nuk kane dorezuar dokumentacion të rregullt lidhur me Akt-Miratimin e qendres se kontrollit në perputhje me Licencen e shoqerise të parashikuar ne ligj. Konkretisht krahasuar nr i licences ne Akt-Miratimin e qendres se kontrollit leshuar nga Drejtoria e Policise Vendore të Qarkut Durres me Licencen e shoqerise të leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit rezultojne mosperputhje të theksuara ndermjet numrave të licences dhe datave ne Akt-Miratimit (si dokument me vete) me numrat dhe datat e Licences (nuk perputhet numri dhe data e Licences). Ne keto kushte gjykojme se operatoret ekonomik Toni-Security, Oktapus, Internazionale Security Albania dhe Vrana Security Group nuk kane dorezuar dokumentacion*

ne perputhje me kriteret e kualifikimit. Duke qenë se ne Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizik shume operatore kane emra të ngjashem kompanish eshte e domosdoshme qe verifikimi i aktit të miratimit të perputhet me numrin e licences se kompanise perkatese. Dokumentacioni i dorezuar nuk eshte i plote e rrjedhimisht nuk eshte i vlefshem per kete procedure prokurimi. Qendrim i mbajtur nga KPP me vendime të ngjashme (vendimi nr. 516/2018 date 03.08.2018).” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, “Kapaciteti teknik” nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se:

1. *Licensë e shoqerisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit te ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;*

2. *Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se BOE “Toni Security” shpk& “Eurogjici Security” shpk si dhe BOE “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm, kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

”Toni Security” sh.p.k. & ”Eurogjici Security” sh.p.k

Akt Miratimi (Për Qendrën e Kontrollit të SHPSF) nr. 55 prot., datë 20.10.2015, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës sipas së cilës, Qendra e Kontrollit të subjektit “Eurogjici Security” sh.p.k nënkategoria 1.3.A e 1.3.B, gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.

Akt Miratimi (Për Qendrën e Kontrollit të SHPSF) nr. 43 prot., datë 09.10.2015, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës sipas së cilës, Qendra e Kontrollit të subjektit “Toni Security” sh.p.k nënkategoria 1.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.

Licencë LN 1195-03-2016 Kodi 1.3.A me datë lëshimi 21.10.2016 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit e operatorit ekonomik “Toni Security” sh.p.k

- Licencë LN 1196-03-2016 Kodi 1.3.A me datë lëshimi 16.03.2016 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k

BOE “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k.

Akt Miratimi (Për Qendrën e Kontrollit të SHPSF) nr. 86 prot., datë 01.09.2016, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës sipas së cilës, Qendra e Kontrollit të subjektit “Trezhnjeva” sh.p.k

nënkategoria 1.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.

Licencë LN 0179-10-2015 Kodi 1.3.A me datë lëshimi 21.11.2016 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k

Akt Miratimi (Për Qendrën e Kontrollit të SHPSF) nr. 02 prot., datë 28.05.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës sipas së cilës, Qendra e Kontrollit të subjektit “I.S.A.” sh.p.k nënkategoria 1.3.A gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.

Licencë LN -8574-10-2014 Kodi 1.3.A me datë lëshimi 04.05.2017 lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit e operatorit ekonomik “I.S.A.” sh.p.k

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

III.4.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, si dhe kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në plotësim të kërkesës së autoritetit kontraktor për licencën e subjektit, dhe aktit të miratimit bashkimi i operatorëve ekonomikë “Toni Security” sh.p.k & “Eurogjici Security” sh.p.k, si dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k. kanë paraqitur licencën e shoqërisë si dhe aktin e miratimit të shoqërisë konform kërkesës së parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për BOE “Toni Security” shpk & “Eurogjici Security” shpk si dhe BOE “I.S.A.” shpk & “Trezhnjeva” sh.p.k. nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k., për kundërshtimin e procedurës së hedhjes së shortit, me argumentin se “Se katerti, Kundërshtojme hedhjen e shortit të dates

17.08.2018, ora 14.00 pasi përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i Kpr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Teresia e elementeve të mesipër lidhet ngushtesisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankuesi është venë në dijeni ose duhet të ishte venë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. " Në nenin 63 pika 3 e lex specialis, LPP parashikohet se "Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni "

Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e lex specialis i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...] ". Qëndrim i mbajtur nga KPP me vendime të ngjashme (vendimi nr. 192/2018 datë 05.04.2018).Referuar sa me sipër konstatojmë se, hedhja e shortit nga autoriteti kontraktor në datën 17.08.2018 është në kundërshtim të hapur me ligjin, pasi është kryer brenda hapesirës kohore në të cilën operatorëve ekonomikë ankimes, ligjerisht, u lindi e drejta e ushtrimit të ankimit administrativ pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. AK ka detyrimin të presë përfundimin e plote të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimes në zbatim të nenit 63 pika 2 pika 3 dhe pikat 6 e LPP-se.

Kerkojmë që nga ana e AK të behet anulimi i shortit të datës 17.08.2018 pasi nuk janë plotësuar afatet e ankimit sipas LPP. ", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Nga verifikimet në informacionin e ardhur pranë KPP me shkresën me nr. 2068/2 prot, datë 07.09.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 1455/2, datë 10.09.2018, nga autoriteti kontraktor, rezulton se ky i fundit në datën 17.07.2018, ora 14:00 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke hedhur shortin për operatorët ekonomikë të kualifikuar me vlerë të njëjtë, nga i cili rezulton fitues në shorte operatori ekonomik "Oktapus" shpk. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia

e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.5.2. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Në nenin 63 pika 3 e lex specialis, LPP parashikohet se “Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e lex specialis i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “[...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.5.3. Bazuar në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.


III.5.4. Në nenin 31 pika 2 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim; [...]”

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në datën 17.07.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar ofertuesit elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe po në datën 17.07.2018 është realizuar hedhja e shortit për ofertat me vlerë të njëjtë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se hedhja e shortit nga autoriteti kontraktor në datën 17.07.2018 është bërë në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduriale të ankimit brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimes i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të

operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së dhe më pas të njoftojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar me ofertë të njëjtë më të ulët, për hedhjen e shortit.

Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për hedhjen e shortit të datës 17.07.2018, nuk është bërë në përputhje me nenin 63 të LPP, duke penguar operatorët ekonomikë të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimimit, në lidhje me klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar, në autoritetin kontraktor dhe KPP, sic parashikohet në këtë dispozitë ligjore. Pas shterimit të kësaj të drejte, autoriteti kontraktor duhet të vazhdojë procedurën e prokurimit me hedhjen e shortit me ofertuesit që kanë paraqitur ofertë ekonomike të njëjtë më të ulët, sic parashikohet në VKM –në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 8, ku thuhet se: “Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. “Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.”

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-76254-06-25-2018, me objekt : me objekt “Blerje e Sherbimit te Ruajtjes me Roje Private” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 13’683’216 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.08.2018 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Oktapus”sh.p.k., “Vrana Security Group” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke i skualifikuar këta ofertues.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e hedhjes së shortit të mbajtur më datë 17.07.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1455 Protokolli;

Datë 31.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Enkeleda Bega**

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**

**Anëtar
Merita Zeqaj**

**Kryetar
Evis Shurdha**

